



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.532/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët; Kujtim Pasuli - kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Ramush Bardiqi - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik, Lista Serbe, me seli në Mitrovicë te Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.02.2025, merr këtë,

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa Anr.532/2025, e datës 10.02.2025, e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë te Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 09 Shkurt 2025.

A r s y e t i m

Me datë 10.02.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën e subjektit politik LVV ne te cilën pretendon se në ditën e zgjedhjeve, përkatësisht më 9 Shkurt 2025, aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE! kanë vërejtur se, në portalin Demos është publikuar lajmi se subjekti politik Lista Serbe përkatësisht zyrtarët e saj të organizuar në grup janë paraqitur në Qendrën e Votimit në Mitrovicën Veriore. Si dëshmi kane bashkangjitur foton e lajmit në portalin Demos. Parashtruesi i ankesës thekson se në rastin konkret subjekti politik Lista Serbe ka vepruar në kundërshtim me nenin 8 paragrafit 1 pika 1.1 të Rregullores Zgjedhore 07/2024 për Fushatën e Zgjedhore ku shprehimisht është përcaktuar se: Nga hapja e qendrave të votimit për votim dhe deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike dhe përfaqësuesve të tyre u ndalohen mbajtja e takimeve për qëllime të fushatës së zgjedhjeve apo grumbullimi i zyrtarëve të subjektit politik të certifikuar në afërsi të qendrave të votimit.

Përmes këtij veprimi, subjekti politik përkatës ka cenuar rëndë dispozitat e Rregullores Zgjedhore të cekur si më lartë. Andaj, duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura, kërkojmë që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në përgjigje e subjektit politik Lista Serbe theksohet se vendvotimi është i njëjtë për të gjithë zyrtarët e subjektit tonë politik. Të gjithë zyrtarët tanë u sollën si votues të zakonshëm, duke votuar në të njëjtën qendër votimi si të gjithë qytetarët e tjerë. Në afërsi të qendrës së votimit nuk u organizuan takime, tubime apo ngjarje politike, dhe se përfaqësuesit tanë nuk kryenin ndonjë aktivitet që mund të perceptohej si tubim politik apo fushatë, përkundrazi, ishte një aktivitet i përcaktuar me ligj, duke shkuar në vendvotim dhe votimi në vetë vendin e votimit. Zyrtarët e Listës Serbe thjesht janë paraqitur në qendrën e votimit për të kryer detyrën e tyre qytetare dhe për të votuar, pas së cilës menjëherë janë kthyer në punët e përditshme, pa ndonjë vonesë apo aktivitete të mëtejshme që mund të ndërliken me fushatën zgjedhore. Duam të theksojmë faktin se, duke qenë se vendvotimet janë të hapura për të gjithë qytetarët, përfshirë edhe zyrtarët tanë, nuk ka bazë për pretendimet se ka pasur shkelje apo se janë shkelur rregullat për mbajtjen e mbledhjeve apo tubimeve afër vendvotimit. Bazuar në të gjitha sa më sipër dhe në përputhje me nenin 118 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, propozojmë që ankesa të refuzohet.

Paneli pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se :

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjeve në ankesë të paraqitur nga subjekti politik Lista Serbe, vlerësoj se pretendimet e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) janë të pa qëndrueshme dhe si të tillë i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk është arritur që të vërtetohet se janë shkelur dispozitat e nenit 37 par. 1 nën par. 1.2 të LZP-së, dhe dispozitat e nenit 8 paragrafit 1 i Rregullores Zgjedhore 07/2024 për Fushatën e Zgjedhore


Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës me te cilën thekson se më 9 Shkurt 2025, subjekti politik Lista Serbe përkatësisht zyrtarët e saj të organizuar në grup janë paraqitur në Qendrën e Votimit në Mitrovicën Veriore, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga fotot e ofruara si dëshmi nuk ka arritur që të vërtetohet se e njëjta ka ndikuar apo ka ndërmarr ndonjë veprim tek votuesit për të ndikuar në mënyrën se si të votojnë ata, apo se te njëjtit kane vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të sipërcituara.

Andaj Paneli vlerësoi se ankesa është e pabazuar pasi që nga provat e ofruara si dëshmi të cilat parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur nuk mund të vërtetohet shkelja e pretenduar për të cilat referohet pala ankuese. Andaj duke u mbështetur në nenin 1 17.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga

veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë. Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 par. 3, neni 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
Anr.532/2025, datë 12.02.2025

Kryesuesi i panelit
Kujtim Pasuli

A circular official stamp in blue ink. The outer ring contains the text "Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia" at the top and "Priştinë / Prishtinë" at the bottom. The inner circle contains the acronym "PZAP" above "IPZP". A handwritten signature in blue ink is written over the stamp.

Këshillë Juridike; Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.